



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Rreg. Nr.01/2017

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, mbështetur në nenin 28. par. 1.10, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 data: 07. Tetor 2010, Gazeta zyrtare nr. 88/25 nëntor 2010 dhe nenit 12. Par. 1.3, të Statutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nr. 04-V- 312 data, 02. 03. 2012, Komisioni I AKK-së në mbledhjen e mbajtur me Dt. 5.19.2017 miraton këtë:

R R E G U L L O R E
PËR PROCEDURAT HETIMORE TË AUTORITETIT KOSOVAR TË
KONKURRENCËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat hetimore që ndjek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në zbatim Ligjit Nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-226 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj. Kjo rregullore është e përafuar me aktet relevante ligjore të Bashkimit Evropian, si dhe është e përafert me praktikat më të mira të vendeve regjionale.

Neni 2
Përkufizimet

Termet e shprehura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

Ligj - do të kuptojmë Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L- 229 i datës: 07 tetor 2010, Gazeta Zyrtare nr. 88/25 nëntor 2010, dhe Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin për Mbrojtjen e Konkurrencës i datës 13 shkurt 2014.

Autoriteti - është Autoriteti Kosovar i Konkurrencës i themeluar me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni - ka kuptimin e strukturës vendimmarrëse të Autoritetit.

Administrata - është administrata e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që kryen punë administrative brenda dhe jashtë Autoritetit.

Sekretari - drejton dhe është përgjegjës për punët administrative të Autoritetit.

Grupi punues - është grupi i punës së zyrtarëve të cilët zhvillojnë procedura hetimore për Autoritetin.

Person i autorizuar - është personi që është i autorizuar për të zhvilluar procedura hetimore për Autoritetin.

Dokument - është çdo grafikë, fotografim ose kinematografike, elektromagnetike ose çdo lloj tjetër përfaqësimi të dokumenteve. Këtu përfshihen edhe dokumentet e brendshme dhe jozyrtare, të cilat janë hartuar dhe janë përdorur për qëllime të veprimtarive të ndërmarrjes, pavarësisht nga niveli i përgjegjësisë së autorit të dokumentit si përfaqësues i ndërmarrjes si dhe çdo dokument tjetër që është hartuar ose është ruajtur në kompjuter.

Neni 3

Zhvillimi i procedurës hetimore nga Autoriteti

1. Në ushtrimin e funksionit që janë në kompetencën e Autoritetit, nëse me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk është e rregulluar ndryshe, aplikohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithëshme Administrative.
2. Zyrtarët e Autorizuar, zhvillojnë procedurat të cilat janë në kompetencën e Autoritetit ndërsa vendimin e merr Komisioni në kuptim të nenit 28. 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Neni 4

Palët në procedurë

1. Palë në procedurë janë ndërmarrjet ndaj të cilave Autoriteti zhvillon procedurën hetimore dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim.
2. Paraqitësi i iniciativës për fillimin e procedurës nga neni 34 i Ligjit nuk e ka pozitën e palës në procedurë.
3. Personi që nuk e ka pozitën e palës në procedurë por ka interes juridik, mund të parashtrijë kërkesë me shkrim që të marrë pjesë në procedim ngjashëm me paraqitësin e iniciativës (i cili nuk e ka pozitën e Palës, nëse argumenton ekzistimin e interesit të tij).
4. Autoriteti lidhur me kërkesën nga par. 3. i këtij neni vendos me Konkluzion në afat prej 30 ditësh.

5. Kundër konkluzionit sipas paragrafit 4 të këtij neni nuk lejohet ankesa por me padi mund të inicohet konflikti administrativ pranë Gjykatës kompetente për Çështje Administrative.

Neni 5

Iniciativa për fillimin e procedurës nga palët e interesuara

1. Në rastet kur iniciativa për fillimin e procedimit administrativ merret nga palët e interesuara, kërkesa duhet të bëhet me shkrim nënshkruhet, përcaktohet data nga personi që kërkon veprimin e Autoritetit ose nga përfaqësuesi ligjor i palës dhe përmbanë:

- a. Emërtimin e organit të cilit i drejtohet;
- b. Data e postimit apo e dorëzimit;
- c. Emërtimin dhe selinë e personit juridik, emër/mbiemër dhe vendqëndrimi i personit fizik që ka paraqitur shkresën;
- ç. Të dhënat e qarta me të cilat kuptohet se kundër cilit është paraqitur iniciativa;
- d. Një indikacion në lidhje me rrethanat dhe kompetencat e Autoritetit në kuadër të të cilit kërkohet veprimi; dhe
- dh. Autorizimin, dokumentet, dhe fakte tjera që disponon paraqitësi i kërkesës, të cilat plotësojnë paraqitjen nga nën paragrafi ç i këtij neni.

2. Nëse paraqitësi i kërkesës mendon se në dokumentet e paraqitura ka fshehtësi afariste është i detyruar t'i argumentoj mbi bazën ligjore.

3. Dorëzimi bëhet duke u bazuar në rregullat që parasheh Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligji për Procedurën administrative.

4. Autoriteti nxjerr formularë me anë të të cilëve marrin informacionet e kërkuara nga personat e interesuar që kërkojnë veprimin e Autoritetit sipas par. 1 të këtij neni.

5. Autoriteti shqyrton kërkesën për veprim drejtuar nga pala e interesuar dhe kryen veprimet e mëposhtme:

- a. Njofton paraqitësin e kërkesës me shkrim se kërkesa është pranuar dhe procedimi administrativ ka filluar ose
- b. Njofton paraqitësin e kërkesës me shkrim se kërkesa nuk është pranuar dhe udhëzon palën se kundër konkluzionit nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicoj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për Çështje Administrative.
- c. Njofton paraqitësin e kërkesës se janë të nevojshme veprime të mëtejme administrative përpara se Autoriteti të fillojë procedurën.

Neni 6

Iniciativa për Fillimin e procedurës nga Autoriteti

1. Procedimin administrativ Autoriteti e fillon sipas detyrës zyrtare dhe sipas kërkesës, propozimit, kundërshtimit ose ndonjë paraqitje tjetër në formë të shkruar të cilën mund ta paraqes çdo person fizik apo juridik, shoqatë profesionale ose ekonomike e interesit, oda ekonomike, shoqatë e konsumatorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, organet e administratës publike qendrore dhe ato lokale.

2. Iniciativa e referuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë:

- a. Emërtimet dhe adresën e selisë së personit juridik apo fizik që ka paraqitur ankesë apo kërkesë;
- b. Emri dhe adresa e selisë së AKK-së;
- c. Dispozitat e ligjit në bazë të të cilave fillon procedura;
- ç. Përshkrimi i gjendjes faktike praktikave ose rrethanave që janë shkak për fillimin e procedurës;
- d. Të dhënat e qarta me të cilat kuptohet se kundër cilit është paraqitë iniciativa;
- dh. Të dhënat personale, dokumente dhe të dhëna tjera që disponon paraqitësi i iniciativës.

Neni 7

Regjistrimi i kërkesës për fillimin e procedurës

1. Pavarësisht nga mënyra e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedurës administrative Autoriteti i regjistron ato në një regjistër të posaqëm në pajtim me dispozitat në fuqi e që përmbanë:
 - a. Nr. të kërkesës;
 - b. Datën e dorëzimit;
 - c. Objektin e kërkesës;
 - ç. Numrin dhe emërtimin e dokumenteve të bashkangjitura me kërkesën dhe
 - d. Emrin Mbiemrin dhe nënshkrimin e kërkuarit.
2. Kërkesat regjistrohen sipas radhës së dorëzimit.

Neni 8

Vërtetimi që i lëshohet palës së interesuar

1. Autoriteti lëshon dëshmi personave të interesuar që paraqesin kërkesën bashk me listën e dokumenteve që i bashkangjiten kërkesës.
2. Të njëjta dispozita vlejnë edhe për kërkesat për rishqyrtim, mendime profesionale, përgjigje apo çdo dokument tjetër shkresor.

Neni 9

Verifikimi paraprak para fillimit të procedurës

1. Përveç verifikimit të kompetencës, e cila bëhet nga Autoriteti menjëherë pas pranimit të kërkesës Autoriteti bënë gjithashtu edhe verifikimet e mëposhtme:
 - a. Nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga personat e interesuar janë parashkruar;
 - b. Legjitimitimi i personit fizik dhe juridik i cili ka dorëzuar kërkesën për fillimin e procedurës;
 - c. Afatet e parashikuara nga ligji për dorëzimin e kërkesës për fillimin e procedurës;
 - d. Nëse kërkesa e një personi fizik apo juridik mund të shqyrtohet bashk me kërkesat e personave tjerë fizik apo juridik.
2. Kërkesa e një personi fizik dhe juridik për fillimin e procedimit administrativ mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e personave të tjerë në qoftë se ato bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

3. Vendimi i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për të shqyrtuar njëkohësisht disa kërkesa mund të kundërshtohet nga palet në procedim.

PROCEDURA HETIMORE

Neni 10

Fillimi i procedurës hetimore

1. Procedura konsiderohet e filluar ditën kur është marrë konkluzioni lidhur me fillimin e procedurës.
2. Procedura hetimore zhvillohet nga Autoriteti ose zyrtari i Autoritetit me autorizim nga Komisioni.
3. Autorizimi mund t'ju lshohet edhe anëtarëve të caktuar të Komisionit në raste të veçanta.
4. Inspektorët hetues të Autoritetit (grupi i punës) kërkojnë dhe njihen me të gjitha faktet në procedurë që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, duke përdorur të gjitha format dhe metodat e lejuara me ligj.
5. Gjatë fazës së hetimit Autoriteti mund të kërkojë informacione dhe dokumente, analiza statistikore dhe ekonomike apo edhe të konsultohet me ekspert të lëmive të caktuara.
6. Për faktet që janë të njohura publikisht nuk nevojitet verifikimi.

Neni 11

Shqyrtimi paraprak i hetimit

1. Në zbatim të nenit 34 dhe 35 të Ligjit, Autoriteti mund të fillojë një procedurë paraprake hetimore:
2. Qëllimi i shqyrtimit paraprak është evidentimi nëse ka ose jo shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, të cilat mund të shërbejnë si shkaqe për hapjen e hetimit të thelluar nga Komisioni, sipas nenit 18 të kësaj Rregulloreje.
3. Sekretari i propozon Komisionit krijimin e grupit të punës. Për çështje komplekse për të cilat kërkohet njohuri të thelluara të fushës përkatëse, Autoriteti mund të kontraktojë një ekspert të jashtëm, i cili mund të jetë pjesë e grupit të punës.
4. Në fillim të kësaj procedure, Grupi i punës është përgjegjës për hartimin e planit të veprimeve. Në përfundim të hetimit, grupi i punës është përgjegjës për hartimin e raportit të shqyrtimit paraprak dhe atë ia paraqet sekretarit i cili e raporton para komisionit për miratim.
5. Gjatë kësaj procedure hetimore, Komisioni mund të kërkojë informacione dhe dokumente si dhe të urdhërojë inspektime, dëshmi ekspertësh, analiza statistikore dhe ekonomike, apo të konsultohet me ekspertë duke ndjekur procedurat sipas neneve 9, 10, 11, 12 dhe 20 të kësaj Rregulloreje.
6. Raporti i shqyrtimit paraprak i miratuar nga Sekretari sipas paragrafit 5 të këtij neni i paraqitet Komisionit për vendimmarrje.
8. Raporti i shqyrtimit paraprak, përmban:

- a) Tregun përkatës, Objekti i hetimit, bazën ligjore, datën e fillimit të hetimit;
 - b) Emri, adresa dhe të dhëna të tjera të palëve të dyshuara për shkelje të ligjit;
 - c) Të dhënat dhe informacionet e grumbulluara gjatë hetimit, sipas nevojës dhe analizën e tyre;
 - d) Shpjegimet e dhëna nga palët, intervistat e kryera me persona të lidhur me çështjen;
- e) Gjetjet me Raportin, rekomandimet dhe propozim vendim përkatëse.
9. Komisioni, bazuar në raportin e paraqitur, në fund të procedurave të shqyrtimit paraprak, mund të vendosë:
- a) Mbylljen e hetimit;
 - b) Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar, sipas nenit 18 të kësaj Rregulloreje;
 - c) Kthimin për rishikim të raportit të hetimit, duke kërkuar hetime shtesë, si dhe duke përcaktuar çështjet që kërkojnë analiza të mëtejshme.

Neni 12 Ekspertizat dhe Masat tjera

1. Gjatë procedimit administrativ, ekspertizat, raportet, vlerësimet dhe masat e tjera të ngjashme, kryhen nga zyrtaret e Autoritetit dhe ne raste të caktuara nga ekspertet e jashtëm të specializuara.
2. Mënyrat e zgjedhjes të ekspertëve të jashtëm rregullohet me ligj.

Neni 13 Njoftimi i palëve të interesuara për ekspertizat

1. Njoftohen palët e interesuara për ekspertizën, qëllimin si dhe për ekspertin ose ekspertët e caktuar nga administrata, me përjashtim të rasteve kur masat kanë të bëjnë me çështje sekrete apo konfidenciale.
2. Njoftimi bëhet në afat prej 10 ditësh para ditës së caktuar për ekspertizën ose masat e tjera dhe përmban datën, orën dhe vendin ku do të zbatohen masat në fjalë.

Neni 14 Caktimi i ekspertëve nga palët e interesuara

Çdoherë që administrata cakton ekspertë edhe pala e interesuar mund të caktojë ekspertët e saj në një numër të njëjtë me ata të administratës.

Neni 15 Paraqitja e pyetjeve për ekspertët

1. Organi që zhvillon procedurën hetimore dhe palët e interesuara mund të parashtrojnë pyetje të cilave ekspertët duhet të përgjigjen ose të kërkojnë nga ata mendime për çështje të caktuara.
2. Organi që zhvillon procedurën hetimore refuzon parashtrimin e pyetjeve nga palët e interesuara, kur pyetjet prekin çështje sekrete apo konfidenciale.

Neni 16

Detyrimet e palëve për të paraqitur provat

1. Zyrtarët që zhvillojnë procedurën hetimore kërkojnë nga palët dhe të tjerët paraqitjen e informacioneve të dokumenteve apo objekteve që i nënshtrohen inspektimit si dhe çdo formë tjetër hetimi për të provuar pretendimet.
2. Palët dhe të tjerët nuk mund të refuzojnë bashkëpunimin.

Neni 17

Barra e provës

Barra e provës bie mbi palët e interesuara në procedimin administrativ, pavarësisht nga detyrimi i Autoritetit për të vënë në dispozicion të palëve provat që zotëron.

Neni 18

Konkluzioni për fillimin e procedurës

Pas shqyrtimit të propozimeve të Sekretariatit, kur vihen re shenja të shkeljes së neneve 4 dhe/ose 11 të Ligjit, Komisioni autorizon Sekretariatit të ndërmarrë një hetim sipas nenit 28 të Ligjit. Sekretariati fillon këtë hetim në çdo kohë që i kërkohet nga Komisioni.

Konkluzioni për fillimin e procedurës bazuar në dispozitat e këtij ligji përmbanë në veçanti:

- 1.1. Numrin e lëndës, datën, me tecilën ka të bëjë konkluzioni;
 - 1.2. Dispozitat e ligjit, në bazë të të cilave fillon procedura;
 - 1.3. Përshkrimi i gjendjes faktike, praktikave ose rrethanave që janë shkak për fillimin e procedurës;
 - 1.4. Kërkesë për ofrimin e të dhënave dhe dokumentacionit sipas nenit 20 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.5. Afati kohor, fillon që nga data e nisjes së lajmërimit për fillimin e veprimeve, brenda të cilit palët e interesuara mund të bëjnë ndonjë ndërhyrje me shkrim.
2. Kundër konkluzionit për fillimin e procedurës nga paragrafi 1. i këtij neni nuk është e lejuar ankesa dhe as padia për inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën kompetente për çështje administrative të Republikës së Kosovës.

Neni 19

Të drejtat e palës në procedurën hetimore

1. Autoriteti një kopje të konkluzionit për fillimin e procedurës, i'a dorëzon palës, kundër të cilës ka filluar procedura respektivisht paraqitësit të kërkesës për përqendrim.
2. Pala kundër të cilës ka filluar procedura dorëzon komentet brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti. Ky afat është i përcaktuar për secilin rast veç e veç, dhe nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë.
3. Në afatin e dhënë, për shkaqe të arsyeshme, pala ka të drejtë të kërkojë zgjatjen e afatit për dorëzimin e komenteve. Autoriteti me konkluzion mund të lejojë zgjatjen e afatit por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë tjera shtesë.
4. Nëse pala nuk vepron sipas kërkesës dhe afatit kohorë, ose në qoftë se deklaron se nuk është në gjendje për të vepruar sipas kërkesës, Autoriteti do të konstatojë faktet dhe rrethanat relevante në procedurë sipas detyrës zyrtare në bazë të njohurive të veta, të dhënave dhe dokumentacionit që disponon, dhe që pa vonesë palës kundër të cilës ka filluar procedura, t'ia dorëzoj njoftimin për faktet paraprake të konstatuara në procedurë dhe pastaj të caktojë një seancë dëgjimore.
5. Nëse procedura ka filluar në bazë të iniciativës se paraqitësit, Autoriteti nuk ia dorëzon paraqitësit të iniciativës konkluzionin, por për fillimin e procedurës e njofton palën me shkrim.

Neni 20 Mbledhja e të Dhënave

1. Autoriteti është i autorizuar që me shkrim:

- 1.1. Të kërkojë nga palët në procedurë, si dhe personat tjerë fizik e juridik, shoqatat e ndërmarrjeve, shoqatat e konsumatorëve, organet shtetërore dhe organet lokale të gjitha informatat e nevojshme, komentet në formë të shkruar ose deklaratat gojore si dhe ofrimin e të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme në shikim;
- 1.2. Shikim të drejtpërdrejtë në të gjitha lokalet afariste, pronat e paluajtshme dhe të luajtshme, librat afarist si dhe bazën e të dhënave në dokumentet tjera, kryerjen e veprimeve tjera që i konsideron të nevojshme për konstatimin e të gjitha fakteve relevante.
2. Kërkesa për mbledhjen e të dhënave duhet të përmbajë:
 - 2.1. Bazën ligjore;
 - 2.2. Lëndën dhe qëllimin e kërkesës;
 - 2.3. Afatin për implementimin e saj;
 - 2.4. Si dhe paralajmërimin e palëve në procedurë dhe personave tjerë fizik e juridik, nëse nuk veprojnë sipas kërkesës, do t'u shqiptohet masa ndëshkuese në pajtim me ligjin.
3. Nëse palët në procedurë dhe personat tjerë fizik e juridik nuk veprojnë sipas kërkesës, Autoriteti me vendim do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do të shqiptoj masën ndëshkuese, ndaj kësaj mase nuk është e lejuar ankesa, por me padë mund të iniciohet konflikt administrativ pranë Gjykatës Kompetente për Çështje Administrative.
4. Të dhënat dhe dokumentacioni nga paragrafi 1. i këtij neni, përmbajnë fshehtësi afariste, palët në procedurë dhe personat tjerë fizik e juridik të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, janë të detyruara që Autoritetit t'i dorëzojnë një shkresë, me shpjegim të qartë, se çka konsiderohet fshehtësi afariste.

5. Në rastin e paragrafit 4. të këtij neni, palët në procedurë dhe personat tjerë fizik e juridik të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, janë të detyruara që Autoritetit të ia dorëzojnë kopjen e dokumenteve afariste që nuk përmban fshehtësi afariste.

6. Nëse palët në procedurë ose personat tjerë fizik e juridik nga paragrafi 1. i këtij neni nuk veprojnë edhe pas ftesës së përsëritur, Autoriteti do të konsiderojë se shkresa e tillë ose dokumentacioni i tillë afarist nuk përmban fshehtësi afariste.

7. Nëse palët në procedurë apo personat tjerë fizik e juridik nga paragrafi 1. i këtij neni nuk i dorëzojnë të dhënat dhe dokumentacionin e referuar në paragrafin 1. të këtij neni, Autoriteti gjatë konstatimit të fakteve do të vlerësojë rëndësin e mos dorëzimit të të dhënave dhe dokumentacionit dhe në përputhje me këtë përcakton faktet relevante.

KONTROLLI I PAPANALAJMËRUAR

Neni 21

Procesi në kontrollin e paparalajmëruar

Inspektimi , Zbatimi, pjesëmarrja, përjashtimi i dokumentacionit dhe procesverbali në kontrollin e paparalajmëruar bëhet sipas neneve 39, 40, 41, 42, 43, të Ligjit.

Neni 23

E drejta e qasjes në dosje

1. Palët në procedurë kanë të drejtë të kërkojnë qasje në dosje me rastin e marrjes së njoftimit për faktet e konstatuara në procedurën paraprake sipas neni 45 të këtij ligji.

2. Pala, me shpenzimet e veta, duhet t'i siguroj Autoritetit të gjitha dokumentet e nevojshme.

3. Kërkesa për qasje, sipas paragrafit 1. të këtij neni, i paraqitet Autoritetit në formë të shkruar.

4. Autoriteti cakton datën për qasje në dosje jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të kërkesës së referuar në paragrafin 3. të këtij neni.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, nuk mund të shikohen apo të përshkruhen vendimet e Autoritetit, procesverbalet apo audio incizimet e takimeve të Komisionit, udhëzimet e brendshme dhe shënimet për rastin, të të gjitha letërkëmbimeve në mes të Autoritetit dhe institucioneve tjera për mbrojtjen e Konkurrencës të shteteve tjera dhe shoqatave të tyre, si dhe dokumentet tjera të cilat konsiderohen fshehtësi afariste sipas nenit 44 të këtij ligji.

6. Paraqitësi i iniciativës pasi të merr konkluzionin që nuk ekziston interes publik për fillimin e procedurës nga neni 35 paragrafi 4. i këtij ligji ose nuk ka fakte për fillimin e procedurës nga neni

36 paragrafi 5. i këtij ligji respektivisht pasi të merr vendimin e Autoritetit me të cilin konstatohet se nuk është çrregulluar konkurrenca tregtare sipas dispozitave të këtij ligji neni 54 nën-paragrafi 1.9. ka të drejt qasjeje në dokumentet në të cilat është bazuar konkluzioni respektivisht vendimi i Autoritetit.

7. Në këtë rast dispozitat e paragrafit 2., 3. dhe 4. të këtij neni vlejné edhe në të drejtën e paraqitësit të iniciativës për qasje në dosje.

8. Pavarësisht nga paragrafi 5. i këtij neni, personat e referuar në nenin 33 paragrafi 2. dhe 3. të këtë ligj nuk kanë të drejtë të qasjes në dosjen e dokumenteve gjatë zhvillimit të procedurës, mirëpo kanë të drejtë për ofrimin e fakteve mbi konstatimet paraprak të fakteve sipas nenit 45 të këtij ligji në formë të shkurtër, nëse kërkohet me shkrim nga Autoriteti. 9 Kundër konkluzionit me të cilin refuzohet kërkesa për qasje në dosje ose pjesë të dosjes, nuk është e lejuar ankesa as inicimi i konfliktit administrativ.

Neni 24

Njoftimi i Fakteve Paraprake të Konstatuara në Procedurë

1. Për t'iu dhënë mundësinë palëve në procedurë sipas nenit 33 paragrafi 2. dhe 3. për ti deklaruar të gjitha faktet relevante dhe rrethanat, Autoriteti duhte edhe para caktimit të seancës dëgjimore me shkrim ti njofton për faktet paraprake te konstatuara në procedurë.

2. Palët në procedurë kanë të drejtë të paraqesin komentet e tyre në njoftimin e referuar në paragrafin 1. të këtij neni, në formë të shkruar, në afat prej një (1) muaji nga dita e marrjes së njoftimit.

3. Përveç komenteve nga paragrafi 2. i këtij neni, palët në procedurë mundën me shkrim të propozojnë dëgjim të dëshmitarëve shtesë dhe të paraqesin prova shtesë.

4. Kopjen e njoftimit nga paragrafi 1. i këtij neni në formë të shkurtër, e cila nuk përmban fshehtësi afariste, Autoriteti në kërkesë të paraqitësit të iniciativës, e udhëzon palën që është i autorizuar dhe kërkon që brenda tridhjetë (30) diteve, nga data e marrjes së njoftimit, me shkrim t'ia ofroj komentet e veta Autoritetit.

5. Kopjen e njoftimit nga paragrafi 1. i këtij neni në formë të shkurtër, e cila nuk përmban fshehtësi afariste, Autoriteti në kërkesë të personit i cili konsideron se në procedurë, për të cilën është i autorizuar të vendosë për të drejtat dhe interes e tijë e udhëzon palën që është i autorizuar dhe kërkon që brenda tridhjetë (30) diteve nga data e marrjes së njoftimit, me shkrim t'ia ofroj komentet e veta Autoritetit.

6. Nëse, pas marrjes së njoftimit nga paragrafi 1. i këtij neni bëhen analiza shtesë që në atë, ose mënyrë tjetër, konstaton fakte të reja ose prova të cilat qartë ndryshojnë gjendjen e konstatuar, Autoriteti mund të merr vendim i cili ndryshon nga konstatimi në njoftimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

7. Në këtë rast Autoriteti para se të marr vendim definitiv, palëve në procedurë ua ofron njoftimin e ri në të cilin i thekson të gjitha faktet relevante, rrethanat dhe konkluzionet.

8. Palët kanë të drejtë edhe në këtë njoftim t'i paraqesin vërejtjet me shkrim dhe propozimet në afat që ia përcakton Autoriteti.

9. Në përputhje me këtë Autoriteti do të veprojë edhe ndaj personave nga paragrafi 4. dhe 5. i këtij neni, të cilëve do t'ua ofrojë njoftimin e ri në formën e shkurtër.

10. Autoriteti nuk mund ta bazojë vendimin e tij në faktet dhe rrethanat për të cilat palëve në procedurë nuk u është dhënë mundësia e mbrojtjes.

Neni 25

Marrja e detyrimeve nga Ndermarrjet

1. Para njoftimit për faktet paraprake të konstatuara në procedurë, pala në procedurë mund të kërkojë nga Autoriteti, marrjen për sipër të detyrimeve që në një afat kohor të ndërmarr masa dhe veprime, për t'i eliminuar efektet negative të veprimeve dhe lëshimeve në konkurrencën në treg.

2. Nëse komisioni vlerëson se masat e propozuara në kërkesë, kushtet dhe afatet e referuara në paragrafin 1. të këtij neni janë të mjaftueshme për të eliminuar efektet negative dhe rivendosjen e konkurrencës, Komisioni me vendim do të pranojë masat e propozuara, kushtet dhe afatet kohore të cilat bëhen të detyrueshme për palën që ka propozuar.

3. Me vendimin e referuar në paragrafin 2. të këtij neni, Autoriteti përcakton afatet në të cilat ndërmarrja duhet të plotësojë kushtet dhe masat e referuara në paragrafin 2. të këtij neni, gjithashtu e detyron ndërmarrjen që të ofrojë prova me të cilat konstatohet përmbushja e kushteve dhe masave në afatin e caktuar si dhe konstaton se nuk ka kushte për vazhdimin e mëtutjeshëm të procedurës ndaj asaj ndërmarrje.

4. Autoriteti mund të pranojë marrjen përsipër të detyrimeve, nga ndërmarrësi, për kryerjen e disa veprimeve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni në rastet kur shkeljet janë në një kohëzgjatje të shkurtër, bashkëpunimi i ndërmarrjeve në procedurë dhe propozimi i masave dhe kushteve në gjashtë (6) mujorin e parë të vazhdimin të procedurës, e posaçërisht nëse është fjala për procedurë që zhvillohet ndaj më shumë palëve, si dhe në rastet tjera kur vlerëson se pranimit për marrjen e masave dhe kushteve sipas paragrafit 1. të këtij neni, është i volitshëm për rivendosjen e konkurrencës së mirëfilltë në tregun relevant dhe pa kohëzgjatje të procedurës.

5. Qëllimin e pranimit të detyrimeve për marrjen e masave dhe kushteve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, Autoriteti do ta publikojë në ueb-faqen e tij të internetit në formë të shkurtër të përshkrimit të lëndës dhe përmbajtjen e masave dhe kushteve, së bashku me ftesën për të gjitha palët e interesuara për paraqitjen me shkrim të vërejtjeve, qëndrimet dhe mendimet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e publikimit.

6. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni, Autoriteti mund të ri-iniciojë procedurën kundër ndërmarrjeve të referuara në paragrafin 2. të këtij neni në rastet:

a. kur vendimi i Autoritetit është marrë në bazë të informatave të pasakta apo të rreme të paraqitura nga palët; ose

b. kur në mënyrë të konsiderueshme janë ndryshuar rrethanat në të cilat është bazuar Autoriteti për marrjen e vendimit.

7. Nëse gjatë mbikëqyrjes së realizimit të masave dhe kushteve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, Autoriteti vërteton se ndërmarrja nuk u përmbahet masave të konstatuara, kushteve dhe afateve nga paragrafi 3. i këtij neni, veprimet e tilla do të konsiderohen shkelje e Ligjit, kjo do të konstatohet me vendim të veçantë me të cilin shqiptohet masa ndëshkuese, në pajtim me dispozitat e Ligjit.

Neni 26 Seanca Dëgjimore

1. Në procedurën e konstatimit të çrregullimit të konkurrencës të cilat i zhvillon Autoriteti, mund të mbahet seancë dëgjimore, nga e cila mund përjashtohet publiku më qëllim për ruajtjen e fshehtësisë afariste.
2. Autoriteti në seancën dëgjimore mund të thërras në cilësinë e dëshmitarit edhe paraqitësin e iniciativës, nëse për këtë ka paraqitur kërkesë me shkrim.
3. Nëse asnjë prej palëve të ftuara, ose të autorizuarit e tyre, nuk kanë ardhur në seancën e parë, Autoriteti mund të shtyjë dhe të planifikojë një seancë të re.
4. Nëse cilado palë në procedurë, ose të autorizuarit e tyre nuk kanë ardhur në seancën tjetër, të caktuar sipas dispozitave të paragrafit 3. të këtij neni, Autoriteti nuk do të caktojë seancë tjetër, por do të kalojë në diskutim me palët e pranishme, në procedurë, për të vendosur vetë në bazë të të dhënave dhe dokumentacionit që disponon.

Neni 27 Masat e përkohshme

1. Autoriteti në raste urgjente inicion procedurën kundër ndërmarrjes së caktuar dhe merr vendim për masat e përkohshme, kur ka rrezik dhe dëmtrim të pariparueshëm për konkurrencën e tregut, sidomos në rastet kur veprimet e caktuara çrregullojnë konkurrencën, bazuar në ligj.
2. Autoriteti kërkon nga ndërmarrësi ndalimin e veprimit në bazë të vendimit për masat e përkohshme nga paragrafi 1. i këtij neni, përmbushjen e kushteve të veçanta apo masave tjera të nevojshme për të eliminuar efektet e dëmshme të çrregullimit të konkurrencës.
3. Kjo masë nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë (6) muaj, ndërsa njoftimi për masën ndëshkuese mund të shqiptohet bazuar në dispozitat e këtij ligji, në rast të mosveprimit, sipas vendimit për masat e përkohshme.
4. Pavarësisht nga paragrafi 2. i këtij neni, kohëzgjatja e masës së përkohshme mund të vazhdohet, nëse Autoriteti konstaton se është e domosdoshme.
5. Kundër vendimit për masat e përkohshme nga paragrafi 1. i këtij neni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi, mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Neni 28 Raporti i hetimit

1. Raporti i hetimit i paraqitet komisionit nga Sekretari për vendimmarrje.
2. Raporti ndër të tjera përmbanë:
 - a. Tregun relevant, objektin e hetimit, bazën ligjore, ditën e fillimit të hetimit;
 - b. Emri, adresa dhe të dhëna të tjera të palëve të dyshuara për shkelje të ligjit;
 - c. Të dhënat dhe informacionet e grumbulluara gjatë hetimit;
 - d. Procesverbalet nga palët, intervistat e kryera me persona që kanë lidhje me çështjen;
 - e. Gjetjet, rekomandimet dhe propozim vendimin.
3. Komisioni bazuar në raportin e paraqitur të hetimit paraparak mund të vendosë:
 - a. Mbylljen e hetimit;
 - b. Kthimin për rishikim të raportit të hetimit, duke kërkuar hetime shtesë.
 - c. Marrja e vendimit perfundimtar.

Neni 29

Ruajtja e dosjeve dhe e dokumentacionit

Shkrimet dhe dokumentet që Autoriteti i merr nga ndërmarrja, gjatë udhëheqjes së procedurës, ose i mbledh dhe përpunon ato për zhvillimin e procedurës, do të ruhen në dosjet e Autoritetit, në pajtim me Ligjin dhe rregullat për ruajtjen e lëndëve arkivore.

Neni 30

Dërgimi dhe publikimi i vendimeve

1. Vendimi i Autoritetit u dërgohet palëve në procedurë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e skadimit të afatit për marrjen e vendimit dhe nëse procedura ka filluar në bazë të paraqitësit të iniciativës, vendimi në të njëjtin afat i dërgohet edhe paraqitësit të iniciativës.
2. Nëse vendimi i Autoritetit përmban informacione që konsiderohen fshehtësi afariste sipas nenit 50 të ligjit, secilës palë, si dhe paraqitësit të iniciativës, do t'i dorëzohet vendimi në arsyetimin e të cilit nuk përmban fshehtësi afariste.
3. Marrja e vendimit të Autoritetit nga neni 54 nën-paragrafi 1.1 deri në 1.7 të ligjit do të publikohet në "Gazetë Zyrtare".
4. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni dhe vendimi i Gjykatës kompetente të Kosovës, në rastin e paraqitjes së padisë ndaj vendimit si dhe akteve tjera të Autoritetit do të publikohen në ueb-faqen e Autoritetit.
5. Të dhënat që konsiderohen fshehtësi afariste, sipas dispozitave të nenit 50 të këtij ligji, do të përjashtohen nga publikimi nga paragrafi 3. i këtij neni.

Neni 31

Dispozitat kalimtare

Hasja ne veshtersi gjate aplikimit te dispozitave te kesaj rregullore apo mungesa e dispozitave per marrjen e vendimit perfundimtare, duhet te aplikohen dispozitat e ligjit per mbrojtjen e konkurrences, ligjit per proceduren e pergjitheshme administrative dhe ligjet tjera qe kan te bejne me shkeljen e rregullave te konkurrences.

Neni 32

Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

Ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e sajë.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)

(_____)
Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

(_____)
Fatime Haziri
Anëtar

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)
Shaqir Morina
Anëtar